




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit



K O N T R A T Ë / S H È R B I M I /

Emri i Projektit: **SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E NXEMJËVE QËNDRORE PËR INSTITUCIONET ARSIMORE ,SHENDËTSI, QENDRA PËR PUNE SOCIALE.**

Numri identifikues: 611-19-160-236, Datë: 02.12.2019; Nr. i arkivit; 02-400-68619

PALËT NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - Drenas, përfaqësuar nga MENSUR GLLAREVA , Zyrtar i Prokurimit (me tutje "Punëdhënës").

GAFUR JASHARI BI DRENAS përfaqësuar nga: GAFUR JASHARI Drejtor (me tutje "Kontraktues")

Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë: **SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E NXEMJËVE QËNDRORE PËR INSTITUCIONET ARSIMORE ,SHENDËTSI, QENDRA PËR PUNE SOCIALE.**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të punëve/shërbimeve / furnizimeve do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹. Periudha e kryerjes së punëve/shërbimeve dhe furnizimeve do të jetë në afatin prej: 10 ditëve.

Neni 3 Çmimi

Çmimi i shërbimeve është në shumën prej: 4,405.00 €, me fjalë (Katerë mijë e Katerëqind e Pesë euro).

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet kur të raporton Menaxheri apo Organi Mbikqyrës i caktuar për përcjelljen **SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E NXEMJËVE QËNDRORE PËR INSTITUCIONET ARSIMORE ,SHENDËTSI, QENDRA PËR PUNE SOCIALE.** duke mos e tejkalar shumën prej: 4,405.00 €,

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Menaxherin e cakton Kryetari në bashkëpunim me Njësin kërkuese e cila e cakton edhe Organin Mbikqyrës . Afati i kryerjes së punëve/shërbimeve/furnizimeve duhet të jetë brenda 10 diteve. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen Drejtoria komunale Për ARSIM ,SHENDETSI,QENDRA PER PUNE SOCIALE

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të punëve/shërbimeve dhe furnizimeve të kryera do të caktohet nga Organi Mbikqyrës apo Komisioni.Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Organi Mbikqyrës apo Komisioni.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për punëve/shërbimeve/ furnizimeve të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertes, t'i arkivoj dhe ruaj.Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve/shërbimeve/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni i shërbimeve

7.1 Garancion per ekzekitim te kontrates 10% te vleres se kontrates me vlefshmeri pre 30 diteve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.**

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në dy origjinale, një origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi menjehere pas nënshkrimit të Kontrates.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	MENSUR GLLAREVA	Emri:	GAFURR JASHARI
Pozita:	ZYRTAR PËRGJEGJËS I PROKURIMIT	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	02.12.2019	Data:	02.12.2019
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

QENDRA PËR PUNË SOCIALE-SERVISIMI I NXEMJES QENDRORE

A	Përshkrimi i punëve	Njesia	Sasia	çmimi nësi	shuma
1	Servisimi i brenerit të naftës ndërmirë i diznes (bazhdarimi) dhe testimi i li	cope	1	250.00	250.00
2	Demolimi i pompave egzistuese dhe dërgimi i tyre në servis.	cope	2	50.00	100.00
3	Servisimi i pompave tip GHR 02 DN 65 servisimi deri në funksionalizim të plot	cope	2	310.00	620.00
4	Montimi i pompave pas servisimit dhe testimi i tyre	cope	2	50.00	100.00
5	Pastrimi i kalldojes komplet nga mbetjet pas ndezjes së Brenerit	cope	1	120.00	120.00
GJITHSEJTI:					1,190.00

QKMF -SERVISIMI I NXEMJES QENDRORE

Nr.	ARTIKUJTI	Njesia matëse	Sasia	Çmimi nësi	Shuma
1	Servisimi i brenerave të peletit	cope	2	150.00	300.00
2	Elektromotor me reduktor 20-110W/20 sjetje në minut-barjta e peletit prej rezervuarit deri të brenerit	cope	2	280.00	560.00
3	Kontrolimi i tabelës së brinerave	cope	2	50.00	100.00
Gjithësejti:					960.00

Qeap "Ardhmëria"

A	Përshkrimi i punëve	Njesia	Sasia	çmimi nësi	Shuma
1	Servisimi i brenerit të naftës ndërmirë i diznes (bazhdarimi) dhe testimi i li	cope	1	300.00	300.00
2	Ndërimi i pllakës së Metalit në deren e kalldojes me pllakë ma e trash se ajo ekzistuese e cila duhet të adaptohet për montimin e Brenerit të naftës	cope	1	120.00	120.00
3	Pastrimi i kalldojes komplet nga mbetjet pas ndezjes së Brenerit	cope	1	90.00	90.00
4	Pastrimi i Oshakut komplet	cope	1	90.00	90.00
5	Furnizimi dhe montimi i diktunit të Brenerit ku ka konkat me deren e Kalldojes diktuni duhet të jetë nga materiali që nuk kalet (zjorrdurues)	cope	1	140.00	140.00
6	Glykol për nxemje qendrore me perberje 1:1 -37 C	kg	125	2.00	250.00
GJITHSEJTI:					990.00

Shfmu "Bajram Curri"

A	Përshkrimi i punëve	Njesia	Sasia	çmimi nësi	shuma
1	Demolimi i Pompes së vjetër dhe dorëzimi i saj të personeli i shkollës.	cope	1	50.00	50.00
2	Adaptimi i gypave të vjetër për montimin e pompes së re sepse pompa e vjetër nuk është e njëjët me pompen e re sepse është model i vjetër	cope	1	5.00	5.00
3	Furnizimi dhe montimi i Pompes IMP GHN Basic 50-120F, Ose të ngjashme me karakteristika të njëjta	cope	1	810.00	810.00
4	Diktuna DN 50	cope	2	15.00	30.00
5	Pastrimi i komplet njetit të ngrohjes Qendrore radiatorave gypave etj	cope	1	370.00	370.00
TOTALI:					1,265.00

REKAPITULLIMI

1	QENDRA PËR PUNË SOCIALE-SERVISIMI I NXEMJES QENDRORE	1,190.00
2	QKMF -SERVISIMI I NXEMJES QENDRORE	960.00
3	Qeap "Ardhmëria"	990.00
4	Shfmu "Bajram Curri"	1,265.00
TOTALI:		4,405.00

SQARIM TENDERI PER QE PARAMASA E NGRITUR ME HERET PER "QEAP ARDHMERIA " DHE "BAJRAM CURRI" KEMI PASUR NJE GABIM TEKNIK QE MUNGON KOLONA "TOTALI PER NJESI", KJO ESHTË PARAMASA PERFUNDIMTARE QE DUHET TE OFERTOHET NGA OPERATORET EKONOMIK